



Republika e Kosovës



Komuna Hani i Elezit

Nr.07/ 1395

PLANI I PUNËS 2025

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Dhjetor, 2024

1.1. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për performancën në:

- Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “ Dr.Menduh Kaloshi “
- Qendrën Për Punë Sociale

Me qëllim të rangimit të prioriteteve sipas rëndësisë së tyre në kuadër të DSHMS-së është se plani i punës duhet të bëhet duke i trajtuar në veçanti objektivat sipas periodave dhe rëndësisë së tyre.

Andaj në kuadër të objektivave për vitin 2025 do të trajtojmë këto objektiva:

Spektori i shëndetësisë

- Ushtrimi permanent i kontrollit të brendshëm me qëllim të ngritjes dhe përgjegjësisë në punë që kanë për synim ngritjen e nivelit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët tanë.

Ky objektivi është trajtuar edhe me menaxhmentin e QKMF-së duke kërkuar që të ndërmarrin të gjitha veprimet konform rregullativës ligjore në fuqi në rrespektimin e orarit të punës, ngritjen e nivelit të shërbimeve shëndetësore dhe të llogaridhënies, ndaj të gjithë atyre që nuk rrespektojnë disiplinën dhe përgjegjësinë në punë do të merren masa ndëshkuese. DSHMS do të ngrit nivelin e monitorimit në të gjitha institucionit në kuadër të kujdesit Parësorë Shëndetësorë.

- Ngritja e gadishmërisë në ndërmarrjen e veprimeve kundrejt situatës së krijuar me pandemin Covid 19 në koordinim ndërinstucional mes institucioneve relevante DSHMS-së, QKMF-së, Institutit Kombëtar të Shëndetësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, duke i zbatuar të gjitha politikat që do të reflektonin në një menaxhim ,
- sa më të mirëfillt të kësaj pandemie, si dhe duke marrë të gjitha veprimet parandaluese,
- Implementimi i mirëfillte i Mjekësisë Familjare duke shtuar numrin e stafit që është në mungesë,
- Ndërmarrja e veprimeve procedurale pran Zyrës së Prokurimit rreth investimeve kapitale (Rregullimi i infrastrukturës së QKMF-së dhe AMF-së),
- Ndërmarrja e veprimeve procedurale pran Zyrës së Prokurimit furnizimit me pajisje shëndetësore, me material shpenzues në koordinim me Qendrën e Mjekësisë Familjare, duke iu referuar kërkesave të QKMF,

- Si pjesë e rëndësishme e punës cilësore është të disponojmë një kontraktues të rregullt me qëllim të gjendjes aktuale dhe mirëmbajtjes së paisjeve të cilat i disponojmë për përdorim në QKMF,
- Do të kërkojmë ndërmarrjen e veprimeve nga menaxhmenti i QKMF-së dhe Ministria e Shendetësisë që të përcjellim procedurat e nevojshme dhe te bëhet asgjësimi i barnave të skaduara.

Sektori i mirëqenies sociale

- I. Qendra për Punë Sociale do të veprojë dhe punojë për realizimin e planit për vitin 2025 në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Statutin e Komunës, Statutin e QPS-se dhe ligjeve të tjera që e rregullojnë fushën e Mirëqenies Sociale me qëllim ofrimin të shërbimeve sa më afër dhe më të mirë për të gjithë qytetarët:

Qendra për Punë Sociale

Do të jetë në shërbim gjatë gjithë kohës në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.

Shërbime sociale për të gjitha kategoritë që kanë nevojë për ndihmë .

Mbajtja e Tryezave për Menaxhimin e Rasteve me qëllim mbrojtjen e fëmijëve .

Bashkpunim me mjetet e informimit për sensibilizim të projektit për “Strehim Familjar” për fëmijët e braktisur dhe ata të strehuar tek të afërmit .

Shërbime psiko-sociale që përfshijnë ofrimin e shërbimeve psikologjike dhe sociale nga punonjësit sociale dhe sipas mundësive buxhetore nga psikologët .

Përkujdesje dhe vizita të vazhdueshme për fëmijët jetim dhe ato me aftësi të kufizuara.

Mbajtja e ligjeratave për të drejtat e njeriut dhe fëmijëve .

Bashkpunim me QKMF, DKA për mbajtje të ligjeratave në shkolla.

Ndihma sociale për familjet në nevojë duke u bazuar në ligjet në fuqi.

Zbatimin e Ligjit të SNS-së nr.2003/15 si dhe ndryshimit dhe plotësimit e këtij ligji nr.04/L096.

Zbatimin e legjislacionit të aplikueshëm për shërbimet sociale dhe familjare, si dhe doracakëve dhe standardeve të aprovuara për mbrojtjen e fëmijëve e kategorive tjera sociale.

Bashkëpunim i ngushtë me Policinë e Kosovës, Prokurorinë dhe Gjykatat e Kosovës.

Bashkëpunimi me DSHMS-së, MPMS, organizatat qeveritare jo qeveritare, vendore dhe ndërkombëtare.

Raportimi i rregullt për nevojat e DSHMS-së, MPMS.

Menaxhimi i punëve dhe detyrave të punës për të gjithë stafin

Kimete Kuka Hasallari
Drejtoreshë e DSHMS-së

